

## VLERA NË KOHË E PARASË

Financa interesohet, jo thjeshtë dhe vetëm për atë cka ndodh aktualisht me mjetet dhe flukst financiare, por edhe me dinamikën e tyre në të ardhmen. Nuk është fort e dobishme që të shqyrtohet aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes sin ë veprim i momentit, por duhet shqyrtuar shtrirjen e saj në kohë si dukuri e ndryshueshme. Për të operuar saktë me teguesit financiar të cdo subjekti ekonomik, për tu dhënë atyre vlera të padiskutueshme dhe për të marrë vendime të rëndësishme, financa operon me konceptin e *vlerës në kohë e parasë*.

Ky concept ka rëndësi pasi që nuk është njëlloj si të zotërosh sot një sasi të caktuar parash, ashtu edhe po të zotërosh të njëjtën sasi parash në një periudhë të ardhshme. Koncepti i vlerës në kohë të parasë lidhet edhe me dy faktorë:

Së pari, nqs dikush zotëron dicka si pronë, ai ka të drejtë të bëjë dh eta përdorë atë si dëshiron. Në këtë kuptim, zotëruesi i parave të sotme mund të bëjë atë që dëshiron. Të zotërosh para do të thotë të zotërosh një aktiv financiar, të cilën je i lirë ta transformojsh në cdo lloj tjetër aktivi.

Së dyti, kur prona që zotëron është para, pronari mund ta kthejë atë në cdo formë që dëshiron, t'i japë asaj formën që mendon, p.sh. mund t'ia japë ato me qira dikujt tjetër dhe prej tyre të fitojë një shtesë – interes apo thënë ndryshe kamatë, dividend, rendiment, rentabilitet, etj. *Vlera në kohë e parasë, e thënë shkurt, tregon se sa kushton “dhënia me qira e parasë”*.

Vlera në kohë e parasë mund të mendohet si një alternativë e zotërimit të parasë për të fituar prej sajë para në formë interesi apo si një mundësi e përdorimit të parasë që zotëron sot, për të rritur sasinë e saj nesër, për ti shtuar asaj para tjetër në formë të interest, duke I kursyer në bankë, pranë një institucioni financiar apo në ndonjë agjenci tjetër që paguan interes.

Koncepti I vlerës në kohë të parasë afirmon se paraja ka vlerë të ndryshme në kohë të ndryshme. Kjo do të thotë se ndryshon jo vetëm vlera e parasë që materializohet si para monetare apo si depozitë, por edhe gjith flukset financiare që shprehen, llogariten e konceptohen në formë monetare. Ky koncept na ndihmon ti kuptojmë edhe shumë variabla të tjera financiare, ndihmon në shpjegimin e dukurive dhe aktiviteteve financiare të ndërmarrjeve, vecanërisht me pasurinë, vlerësimin e investimeve dhe transformimin e tyre.

### 1.2.Vlera e ardhme

Një euro në dorë sot është më e vlefshme se një euro e zotëruar, të themi pas një viti. Kjo është e qartë, sepse një euro e zotëruar sot mund të përdoret gjatë periudhës një vjecare dhe, pas kësaj ajo do të rritet, do të bëhet, p.sh. në rastin më pak të favorshëm 1,01 euro. Rritja 0.01 euro vjenë nga përdorimi I parasë së poseduar në fillim të vitit. Në jetën e përdicme ndërmarrjet përdorin flukes monetare shumë më të mëdha dhe përdorimi I tyre lidhet jo thjeshtë me llogari kursimi ku diskutohet 0.5 dhe 1 % përfitim, por me alternative të tjera investimi, që sigurojnë përfitime disa herë më tepër.

Kështu, në qoftë se firma X vendos 1000 e. në një llogari që paguan 8% interes vjetor, në fund të vitit të parë ajo do të ketë 1.080 e. Shuma 1.080 e. përbëhet nga shuma fillestare 1.000e. plus interesin 80e. Vlera e ardhme në fund të vitit të parë është e barabartë me  $1000(1+0.08)=1.080$ . Në qoftë se firma këto para do ti lërë në atë llogari edhe një vit tjetër, atë herë ajo do të marrë edhe një interes 8% të ribe llogaritur mbi shumën 1.080e. Në fund të vitit të dytë, firma do të ketë në llogarinë e saj 1.166,40e. Kjo shumë formohet gjithmonë nga shuma fillestare 1.000e, rritja e llogaritur prej 8% mbi shumën fillestare në fillim të vitit të parë dhe nga rritja e llogaritur prej 8% mbi shumën e akumuluar në fund të vitit të parë.

Vlera e ardhshme në fund të vitit të dytë është e barabartë me:

$$1.080*(1+0.08) = 1.166,40 \text{ ose}$$

$$1000*(1+0.08) (1+0,08) = 1.000 (1+0.08)^2 = 1.166,40e.$$

Në qoftë se shënojmë me:

FV= vlera e ardhme e një shume ose shuma në fund të një periudhe prej n vite

P= shuma fillestare

$i$ = përqindja e interes vjetor të paguar në llogari

$n$ = numri i viteve, i periudhave, gjatë të cilave parja vendoset në llogari.

atëherë:

Vlera e ardhme e parasësë vendosur në depozitën që paguan  $i$  interes dhe pas  $n$  viteve do të llogaritet me formulën:

$$FV= P (1 + i) ^n$$

Shembull: A.A. ka vendosur shumën 8.000 e. në një llogari kursimi që paguan interes vjetor 6%, llogaritjet e të cilit i bënë një herë në vit. Pas 5 vitesh, ai dëshiron të përballojë me ato shpenzimet për shkollimin e vajzës në universitet. Sa para do t'i jenë akumuluar AA në këtë llogari pas 5 vitesh.

P= 8.000;  $i=6\%$  ose 0.06 dhe  $n= 5$  vite; atëherë

$$\begin{aligned} FV &= 8.000 (1+0.06)^5 \\ &= 8.000 * 1.338 = 10.704 \text{ e. ,} \end{aligned}$$

Tabela e interes të vlerës së ardhme

Llogaritja e vlerës së shprehjes  $(1+0,06)^5$  që rezultoi 1.338 u mundësua nga tabela e cila e lehtëson shumë procesin e llogaritjes së vlerës së ardhme. Në përgjithësi, ndërtimi i tabelës kthehet në llogaritjen e një numri të madh vlerash të shprehjes  $(1 + i)^n$ , për  $i$  dhe  $n$  të ndryshueshme.

Faktori interes i vlerës së ardhme FVIF, për një njësi monetare (1e).

Periudha	5%	6%	7%	8%	9%	10%
1	1,050	1,060	1,070	1,080	1,090	1,100
2	1,102	1,124	1,145	1,166	1,118	1,210
3	1,198	1,191	1,225	1,200	1,295	1,331
4	1,216	1,262	1,311	1,300	1,412	1,404
5	1,276	1,338	1,408	1,469	1,539	1,611
6	1,349	1,419	1,501	1,578	1,677	1,772
7	1,407	1,501	1,606	1,714	1,828	1,949
8	1,477	1,504	1,718	1,851	1,998	2,144
9	1,551	1,689	1,838	1,999	2,172	2,358
10	1,629	1,791	1,967	2,159	2,367	2,594

### 1.3. Si llogaritet interesi i përbërë

Supozojmë se zotërojmë shumën 1.000e. të cilën do ta ruajmë në formë depozite, me inters 6% për 5 vjet resht. Kërkohet se sa euro do të zotërojmë në fund të cdo viti dhe në fund të vitit të 5-të.

Problemi zgjidhet thjesht, me ndihmën e formulës së paraqitur më sipër;

$$FV = 1.000 (1 + 0.06)^5 = 1.000 * 1.338 = 1.338 \text{ e.}$$

Shuma fillestare 1.000 e. arrin në shumën 1.338 e. duke kaluar në disa faza, sic paraqitet në tabelën 2.2. që vijon.

Tab.2.2. Llogaritja e interest të përbërë

Viti	Shuma në fillim të vitit (P) në Euro	$(1+i)$	Shuma në fund të cdo viti (FVn) në Euro	Interesi i ftuar $P * i$
1	1.000	1.06	1.060	+60
2	1.060	1.06	1.124	+64
3	1.124	1.06	1.191	+67
4	1.191	1.06	1.262	+71
5	1.262	1.06	1.338	+76
				338

Sic shihet në tabelë :

$$FV2 = FV1(1+i) = P (1+i) (1+i),$$

$FV3 = FV2 (1+i) = P(1+i) (1+i) (1+i) = P (1+i)^3$ , e kështu me radhë, ndaj përfundimisht kemi:

$$FV5 = P(1+i)^5 = 1.338 \text{ e.}$$

Nga shqyrtimi me kujdes i tabelës së interest dalin tre përfundime kryesore:

1. Tabela paraqet vlerën e ardhme të një njësie monetare pas  $n$  vitesh.
2. Me rritjen e faktorit interes  $i$  , vlera e ardhme rritet.
3. Kur niveli i interest nuk ndryshon, vlera e ardhme rritet me rritjen e kohës  $n$ .

#### 4. Vlera e ardhme, kur llogaritjet bëhen për periudhat brenda vitit

Llogaritja e interest për një shumë të vendosur në depozitë nuk bëhen vetëm për periudha maturimi 1 vjecare. dhe as vetëm në fund të vitit. Flukset e parasë nuk mund të lihen në përdorim të ndërmjetësve financiarë, për rrjedhojë as të bankave, pa kurfarë interesi qoftë edhe për periudha edhe më të shkurtra sa sa një vit. Nga ana tjetër bankat dhe institucionet financiare janë tepër të interesuar për grumbullimin e mjeteve monetare si deposit. Këto institucione pranojnë deopozita dhe llogarin e paguajnë interes edhe për periudha më të shkurtra se një vit, për periudha 6 mujore, 3 mujore, mujore, javore dhe ditore. Duhet theksuar se interest që publikohen dhe i komunikohen publikut të gjërë janë gjithmonë në përqindje, si interes vjetor mbi shumën e vendosur në depozitë. Me ndihmën e tabelave të interest dhe të formulave të trajtuara më sipër, mund të përcaktohet gjithashtu edhe vlera e ardhme e një shume, kur llogaritjet bëhen për periudha të ndërmjetme, më të vogla se një vit.

**Llogaritjet 6 – mujore të interest.** Kur llogaritjet e interest bëhen për periudha 6 mujore, kjo dmth se periudha vjetore ndahet në dy nënperiudha llogaritëse nga 6 muaj secila. Kjo dmth. Akoma se interesi vjetor pjestohet me dy, për t'u kthyer në inters 6 mujor.

Shembull; Një firmë X mori vendim të depozitojë shumën 1.000 e. në një llogari kursimi që paguan interes vjetor 8% dhe llogaritja e përfitimit të interest bëhet cdo 6 muaj. Duam të dimë se sa do të jetë vlera e ardhme e kësaj shume mbas dy viteve, si dhe në fund të cdo periudhe llogaritjeje.

2.3. Llogaritja e vlerës së ardhme për periudha 6- mujore

Periudha	Periudha në fillim në Euro (1)	FVIF (2)	Vlera e ardhme FV
----------	--------------------------------	----------	-------------------

			3= (1)*(2)
6-mujore	1.000	1,04	1.040,00
1 vjecare	1.040	1,04	1.81,60
18 mujore	1.081,60	1,04	1.124,90
2 vjet	1.124,90	1.04	1.169,90

Sic shihet vlera e ardhme në fund të vitit të parë rezulton 1.081,60 e. ndërsa në fund të vitit të dytë 1.169,90 e.

**2.4. Llogaritja e vlerës së ardhme për periudha 3 mujore-** kjo nënkupton që interesi vjetor do të kthehet në interes tremujor, duke e pjestuar me 4. P.sh. shuma fillestare e depozituar = 1.000 e., interesi vjetor 8%, llogaritjet 3 mujore, periudha e depozitës 2 vjet.

Tabela 2.4 Llogaritja e vlerës së ardhme për periudha 3 mujore

Periudha	Shuma në fillim (1)	Faktori interes i FV (2)	Vlera e ardhme në fund të periudhës
3-mujore	1.000	1.02	1.020,0
6-mujore	1.020	1.02	1.040,40
9-mujore	1.040,40	1.02	1.061,20
12- mujore	1.061,20	1.02	1.081,40
15-mujore	1.082,40	1.02	1.104,00
18-mujore	1.104,00	1.02	1.126,10
21-mujore	1.126,10	1.02	1.148,6
2 vjecare	1.148,60	1,02	1.171,60

## 2.7. Përqindjet ekuivalente të interesit

Përqindjet e interesit janë të shprehura përgjithësisht në formë të % nominale të interesit (p.sh. 6% në vit). Llogaritja e interesit mund të bëhet, vjetore, 6 mujore, 3 mujore apo mujore dhe llogaritja e interesit mund të ndryshojë nga një periudhë në tjetrën, atë herë në këto raste, për efekte krahasimi të interesit të huave llogaritjet një nivel mesatar interesi. Ky nivel mesatar quhet përqindje ekuivalente e interesit dhe përcaktohet % e interesit në qoftë se pagesa e interesit bëhet çdo vit.

Për të gjetur përqindjen ekuivalente të interesit me të dhënat e shembullit të më sipërm vlerën e ardhme në fund të vitit të 1e të vendosur në fillim të vitit. Do të kemi:

$$FV=(1,05)^{12} = 1,0\ 616\ 788$$

Përqindja e interesit ekuivalent është e barabartë me këtë shifër minus 1.

Përqindja ekuivalente =  $1,0\ 616\ 778 - 1 = 0,0\ 616\ 778$  ose

6,16 778% në vit.

Formula për llogaritjen e interesit ekuivalent është:

$$\text{Interesi ekuivalent} = (1 + \text{interesi vjetor}/m)n - 1$$

Kur interesi vjetor i korrespondon përqindjes së deklaruar të interesit mbi huanë ose mbi investimin, m-përfaqëson numrin e periudhave të pagesave të interesit brenda 1 viti.

Në vijim në tabelën e më poshtme do të paraqiten në formë të detajuar % ekuivalente të interesit me frekuenca të ndryshme kapitalizimi, kur interesi vleror është 6%.

Tabela 2.7. Përqindja ekuivalente e interesit vjetor 6%

Nr.	Frekuenca e kapitalizimit	M	% ekuivalente e interesit
1	Vjetore	1	6,00 000 %
2	Gjashtëmujore	2	6,09 000 %
3	Tremujore	4	6,13 614 %
4	Mujore	12	6,16 778 %
5	Javore	52	6,17 998 %
6	Ditore	365	6,18 313 %
7	E vazhduar	Infinit	6,18 365 %

## 2.9.Vlera aktuale

Vlera aktuale e një shume të vetme të dhënë, të ofruar pas n vitesh me kushtet e interesit i %, konsiderohet shuma që, sot a zotëronim sot dhe, duke e vendosur në një depozitë për të njëjtën periudhë, si dhe me të njëjtën normë interesi, do të na jepte shumën e ardhshme. Përqindja e interesit të këtij zhvlerësimi quhet ndryshe kosto oportune, % skontimi, % e kthimit ose kosto e kapitalit.

P.sh. kur shuma 100 e. e poseduar sot, është e barabartë me shumën 127,6 e. që do të posedojmë pas 5 vitesh. Shuma 100 e. sot quhet vlera aktuale e shumës 127,6 e. pas 5 vitesh, me interesin 5%.